

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N.Gj., nga Gjakova, të cilin e përfaqëson Xh.K., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për anulimin e vendimit dhe konkursit, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1864/2013, datë 21.12.2015, në seancën e mbajtur më 01.03.2016, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit N.GJ., nga Gjakova, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1864/2013, datë 21.12.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1864/2013 datë 21.12.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.99/2012, datë 20.03.2013, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është refuzuar kërkesëpadija e paditësit, me të cilën ka kërkuar të anulohet konkursi i datës 16.12.2008 dhe vendimi Ref.nr.... i datës ..., i të paditurës, si i kundërligjshëm, kurse paditësit t'i njihet e drejta e vendit të punës së asistentit të arsimit special në shkollën fillore "...” në Gjakovë. Me pjesën II të dispozitivit, është vendosur që secila palë t'i heqë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur me kohë revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dyja gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadija e paditësit të aprovohet ose ato të prishen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 16 dhjetor 2008, e paditura ka shpallur konkurs për vendin e punës interpretues i gjuhës së shenjave në sektorin e Arsimit Special për shkollën fillore “...” në Gjakovë. Për këtë vend të punës ka aplikuar paditësi dhe kandidatja K.M., e cila pranohet në këtë vend të punës, ndonëse nuk i plotësonte kushtet e konkursit. I pakënaqur me këtë vendim, paditësi i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili, me vendimin e datës 23.03.2009, ka aprovuar ankesën e paditësit dhe i ka anuluar të gjitha veprimet e autoritetit-punëdhënësit në lidhje me konkursin e shpallur nga e paditura të datës 16.02.2008, si dhe vendimin e kandidatit për vendin e punës inspektues i gjuhës së shenjave; po ashtu, është anuluar edhe vendimi i Komisionit të ankesave, Ref.nr... datë ... Me vendimin në fjalë, është detyruar sekretari permanent i Arsimit Special dhe menaxheri i personelit i të paditurës që, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishpallin konkursin për vendin e punës interpretues i gjuhës së shenjave.

E paditura, me referencën nr... datë ..., e njofton Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës se vendimi i këtij organi nuk ka mundur të zbatohet, për shkak të mungesës së nxënësve me nevoja të veçanta në këtë shkollë, gjë që ka bërë që të pushojë edhe nevoja për pranimin e mësimdhënësit interpretues të gjuhës së shenjave.

Gjykata e shkallës së parë, nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi kërkon anulimin e vendimit inekzistent, i cili është anuluar dhe nuk është ndërmarrë procedura e parashikuar ligjore nga ana e paditësit për zbatimin e vendimit të KPMK-së, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nisur nga një gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, duke refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban as të meta që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij, pra edhe kjo Gjykatë mendon se gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi paditësi kërkon anulimin e vendimit i cili faktikisht është anuluar nga ana e KPMK-ës. E paditura nuk ka marrë vendim për plotësimin e vendit të punës sipas konkursit, për shkak të pushimit të nevojave për pranimin e një mësimdhënësi interpretues të gjuhës së shenjave, në mungesë të nxënësve me nevoja të veçanta në atë shkollë. Po ashtu, paditësi ka lënë pa i ndërmarrë procedurat e parashikuara ligjore për zbatimin e vendimit të KPMK, në kuptim të dispozitës së nenit 13 dhe 15 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës (Ligji nr.03/L-192). Prandaj kjo Gjykatë i cilësoi si të pabazuara thëniet në revizion se aktgjykimet e të dyja gjykatave janë marrë në bazë të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimet e të dyja gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore parashikuar nga dispozita e nenit 182 par 2 pika n) të LPK-ës, kjo Gjykatë i vlerësoi si të paqëndrueshme, për faktin se paditësi nuk jep fare arsye në revizionin e tij në kuptim të ligjit, se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur dhe brenda kufijve dhe shkaqeve të vëna në dukje në revizion (neni 215).

Kjo Gjykatë i vlerësoi parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi nuk përmban arsye për çështjet vendimtare, sikurse edhe pretendimet ankimore, por gjeti se ato janë të papranueshme, duke qenë se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje të tilla, por është i qartë dhe përmban arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet vendimtare që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Nga sa u tha më sipër dhe me zbatimin e dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.48/2016 datë 01.03.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani